

Coronavirusi transmetohet nga një person në tjetrin përmes të ashtuquajturit **infeksion me anë të piklave**. Kështu që virusi mund të përhapet përmes ajrit, por edhe përmes duarve ose sendeve të përdorura bashkarisht. Para se të fillojë shkolla, duam t'ju udhëzojmë për disa rregulla të rëndësishme:

Sëmundjet e mëparshme:

Nëse nxënësit e shkollës vuajnë nga sëmundje të mëparshme që lidhen me coronavirusin (COVID-19), kujdestarët ligjorë vendosin, nëse është e nevojshme pasi të këshillohen me një mjek, nëse shëndeti i fëmijës së tyre mund të rrezikohet nga frekuentimi i shkollës. Në këtë rast, kujdestarët ligjorë lajmërojnë **menjëherë** shkollën dhe njoftojnë me shkrim se, për shkak të një sëmundjeje të mëparshme, parimisht rrezikohet shëndeti i fëmijës së tyre nëse ai/ajo shkon në shkollë. Lloji i sëmundjes së mëparshme nuk duhet të specifikohet për arsye të mbrojtjes së të dhënave. Sa më sipër vlen edhe për nxënësit që kanë arritur moshën madhore.

Si sëmundje të mëparshme që vlejnë për këtë rast, janë:

- Sëmundjet kardiovaskulare që kërkojnë terapi (p.sh. Sëmundja koronare e zemrës, tensioni i lartë i gjakut)
- Sëmundjet e mushkërive (p.sh. COPD, astma bronkiale)
- Sëmundja kronike e mëlçisë
- Sëmundja e veshkave
- Kanceret
- Diabeti melitus
- Sistemi imunitar i dobësuar (p.sh. për shkak të një sëmundjeje që shoqërohet me imunodeficiencë ose nga marrja e vazhdueshme e ilaçeve që ndikojnë dhe zvogëlojnë mbrojtjen imune, siç është p.sh. kortizoni)

Si rezultat **nuk zbatohet** detyrimi për të **marrë pjesë në mësimet në klasë**. Me këta nxënës do të vazhdohet hëpërhë mësimi online. Këtyre nxënësve do t'u mundësohet **pjesëmarrja në provime** përmes masave speciale. Në lidhje me këtë, ju lutemi të kontaktoni mësuesin tuaj kujdestar.

Rregullat e sjelljes:

Vlejnë dy parime të qarta:

- Midis të gjithë personave në shkollë duhet të ruhet **distanca minimale prej 1,5 metrash**.
- **Lani duart** rregullisht dhe për një kohë mjaftueshëm të gjatë (të paktën 20 sekonda) me ujë dhe sapun, veçanërisht pasi keni fryrë hundën, tështirë ose jeni kollitur.

Gjithashtu kini parasysh:

- Mos **prekni fytyrën me duart**, shmangni prekjen me duar të gojës, syve ose hundës.
- Respektoni etiketën në rast kollitje dhe teshtitje: **Teshtini ose kollituni** në gropën e krahut ose në një façoletë dhe hidhni atë direkt në koshin e plehrave.
- Mos i **shtrëngoni duart me të tjerë, mos u përqafo**ni dhe **mos u përshëndetni me puthje**.
- Mos përdorni asnjë **artikull të përdorimit të gjerë** si gota, shishe për të pirë, lugë etj. së bashku me të tjerë.
- Kur të fillojë shkolla shkoni **direkt** në klasat e caktuara.
- Largohuni menjëherë **pas mbas mbarimit të mësim**it nga shkolla dhe nga ndërtesa e shkollës.
- **Mos formoni grupime** në oborrin e shkollës ose në ndërtesën e shkollës. Edhe jashtë klasave është e detyrueshme ruajtja e **distancës minimale prej 1,5 metrash**.
- Edhe në **tualete** rregulli i ruajtjes së distancës (1,5 metra) duhet të respektohet në çdo kohë.
- Kini parasysh **vendkalimet e shënuara** në ndërtesë.
- Nëse ka **ashensorë, mund të përdoren** vetëm nga një person i autorizuar.
- Në veçanti, ethet, kolla dhe vështirësitë në frymëmarrje mund të jenë shenja të infeksionit me koronavirusin. Nëse konstatoni **simptomat** përkatëse, ju lutemi njoftoni menjëherë mësuesen ose mësuesin tuaj ose qëndroni në shtëpi. Për më tej vlejnë rregullat e përgjithshme për mungesat me arsye për shkak sëmundjeje.

Gefördert durch:

Ministerium für Kinder, Familie,
Flüchtlinge und Integration
des Landes Nordrhein-Westfalen

